



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr.2073 / _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Për: OE: **Erzeni/SH - NIPT J66902027T**, Adresë: Tiranë, "Dervish Hima", 3 kullat K.3, AP 9/2,

* * *

Procedura e prokurimit: Procedure e hapur- mallra- **prokurim me mjete elektronike.**

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-58400-05-18-2020

Lot. 4 REF-58408-05-18-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"F.V pajisje mjekësore për spitalet si dhe pajisje hotelerie mjekësore për fazën e I-rë për Spitalin Kukës" me fond limit në total 91,666,742 (nëntëdhjetë e një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e dyzetë e dy) Lekë pa TVSH ndarë në 4 lote:**

LOT. 4 "F.V Pajisje hotelerie spitalore" me fond limit 6,501,495 (gjashtë milion e pesëqind e një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH.

Data e zhvillimit të tenderit: 17.06.2018

Kohëzgjatja e kontratës: **Lot 1 – Kohezgjatja e Kontrates: Brenda 45 diteve nga data e lidhjes se kontrates.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X, oferta ekonomikisht më e favorshme
Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

LOT. 1 "F.V Pajisje të ndryshme mjekësore" me fond limit 33,298,580 (tridhjetë e tre milion e dyqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH

Loti 4

1. **OE Erzeni/SH** - me NIPT J66902027T, Adresa: Lagjja "Bahçallek, Rruga Nacionale Shkodër – Tiranë , me ofertë ekonomike **5,791,955** (pese milion e shtateqind e nentedhjetete nje mije e nenteqind e pesedhjetete e pese leke); pa TVSH
2. **OE Linear** - me NIPT L01714002F **5,899,458.39** (pesë milion e teteqind e nentedhjetete e nente mije e katerqind e pesedhjetete e tete pike tridhjetete e nente) Lekë; pa TVSH;
3. **BOE Fedos/Junik** - FEDOS shpk - me NIPT K01514009I, Adresë: Rr. Manol Konomi, Ndërtesa 14, Hyrja 2, Ap 2, Tiranë dhe **JUNIK** shpk me NIPTJ68007522L, Adresa: Lagjja SMT, Ndërtesa 2-Katëshe, Kati 2-të, Lezhë, përfaqësuar nga OE FEDOS, me ofertë ekonomike 5,900,005 (pesë milion e nëntëqind mijë e pesë) Lekë pa TVSH.
4. **OE Erald** - me NIPT J74517205P, Adresa: Nikel, Qerek, Rruga Nacionale Tiranë – Fushë Krujë, Km136.**075.240** (Gjashtë milion e shtatëdhjetë e pesë mijë e dyqind e dyzet) lekë; pa TVSH;

5. **OE Bolt** - me NIPT K91517011V, Adresa: Rr. Dritan Hoxha, Blloku Gintash, Laprakë, Tiranë **6 458 110** (Gjashtemilion e katerqind e pesedhjetë e tetemije e njeqind e dhjete) leke pa TVSH;
6. **OE RO-AL** - me NIPT J61811001M, Adresa: Tiranë, Kashar, Km 8, Autostrada Tiranë-Durrës, me ofertë ekonomike **6,501,495** (gjashtë milion e pesëqind e një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- **OE Linear** - me NIPT L01714002F 5,899,458.39 (Pesë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katerqind e pesedhjetë e tete pike tridhjetë e nente) Lekë; pa TVSH;
- **OE Erald** - me NIPT J74517205P, Adresa: Nikel, Qerek, Rruga Nacionale Tiranë – Fushë Krujë, Km13, 6.075.240 (Gjashtë milion e shtatëdhjetë e pesë mijë e dyqind e dyzet) lekë; pa TVSH;
- **OE Bolt** - me NIPT K91517011V, Adresa: Rr. Dritan Hoxha, Blloku Gintash, Laprakë, Tiranë 6 458 110 (Gjashtë milion e katerqind e pesedhjetë e tetemije e njeqind e dhjete) leke pa TVSH;
- **OE RO-AL** - me NIPT J61811001M, Adresa: Tiranë, Kashar, Km 8, Autostrada Tiranë-Durrës, me ofertë ekonomike 6,501,495 (gjashtë milion e pesëqind e një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Referuar, dokumentacionit të dorëzuar në sistem nga OE e sipërcituar, KVO konstaton si mëposhtë:

- Shoqëritë, **OE Linear, OE Erald, OE Bolt dhe OE RO-AL**, nuk plotësojnë KVK sipas DST.

Rrjedhimisht ofertat e këtyre shoqërive rezultojnë si jo të plota dhe të parregullta.

- **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE LINEAR shpk - me NIPT L01714002F, Adresa: Tiranë, Kashar, Kthesa Kamzës, Rr.Kastriotit, Pll Nr. 5, Shk Nr. 4, Ap Nr. 3, KVO vlerëson dhe vendos si më poshtë:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kësaj shoqërive rezultoi se ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në Kriteret e Përgjithshme për Kualifikim (KPK).

Dokumentacioni i paraqitur për plotësimin e kriterëve të vecanta për kualifikim (KVK) rezulton jo i plotë dhe nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në DST, konkretisht,

Pika, 2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi.

Per te permbushur kriterin e mesiperm OE ka ngarkuar ne SPE Sherbime_te _ngjashme__Furnizime ne cilin jane ngarkuar dokumenta te cilat nuk permbushin KVK nr. 2.3.1 per arsye se kane te bejne me mirmbajtjen e pajisjeve mjekesore dhe jo me objektin e kesaj procedure prokurimi F.V. pajisje mjekesore per spitalet dhe pajisje hotelerie mjekesore.

9. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transporti mallrash, me kapacitet transportues të paktën 1 (një) ton me qëllim transportin e mallit, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës, si më poshtë:

a) Dokument që vërteton pronësinë ose qiramarrjen, si më poshtë:

➤ *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*

- Kontratë qiraje.

b) Leje qarkullimi e mjetit;

c) Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore;

d) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve;

e) Certifikate për transport mallrash (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton);

Per te permbushur kriterin e mesiperm OE ka ngarkuar ne SPE Dokumenta_Mjet_Transporti, Kontrate_Qeraje, dhe Kontrate_Shit-Blerje, ne te cilat jane ngarkuar dokumenta qe nuk permbushin KVK nr. 2.3.9.e, e) Certifikate për transport mallrash (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton);

Për sa më sipër, KVO në unanimitet vendosi për skualifikimin e ofertës së OE LINEAR shpk.

- **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE ERALD shpk - me NIPT J74517205P, Adresa: Nikel, Qerek, Rruga Nacionale Tiranë – Fushë Krujë, Km13, KVO vlerëson dhe vendos si më poshtë:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kësaj shoqërive rezultoi se ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në Kriteret e Përgjithshme për Kualifikim (KPK).

Dokumentacioni i paraqitur për plotësimin e kriterëve të vecanta për kualifikim (KVK) rezulton jo i plotë dhe nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuar në DST, kokretisht

Per te permbushur KVK nr. 2.3.2, Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese (të plotësohet në shtojcën 1 të DST).

Nga verifikimi i dokumentacionit te ngarkuar rezulton se ky kriter nuk permbushet.

Per te permbushur KVK nr. 2.3.4, Ofertuesi duhet të paraqesë Certifikatë ISO 13485:2016 ose ekuivalent, "Per Sistemin e menaxhimin te cilesise per pajisjet mjekësore", e vlefshme, **për prodhuesit** e artikujve Nr. 1, 3,4,5,6,7,11,12 dhe Nr.19. Certifikatat të jenë te lëshuar nga

organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, brenda afatit te vlefshmerise, ne gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara.

Nga verifikimi i dokumentacionit te ngarkuar ne Spe rezulton se Certifikatat e larte permendura, jane te vlefshme deri me daten 21.06.2019, pra nuk jane brenda afatit te vlefshmerise.

Për sa më sipër, KVO në unanimitet vendosi për skualifikimin e ofertës së OE ERALD shpk.

- **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE BOLT shpk - me NIPT K91517011V, Adresa: Rr. Dritan Hoxha, Blloku Gintash, Laprakë, Tiranë, KVO vlerëson dhe vendos si më poshtë:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kësaj shoqërive rezultoi se ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në Kriteret e Përgjithshme për Kualifikim (KPK).

Dokumentacioni i paraqitur për plotësimin e kriterëve të vecanta për kualifikim (KVK) rezulton jo i plotë dhe nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuar në DST, konkretisht:

Per te permbushur KVK nr. 2.3.4, Ofertuesi duhet të paraqesë Certifikatë ISO 13485:2016 ose ekuivalent, "Per Sistemin e menaxhimit te cilesise per pajisjet mjekësore", e vlefshme, **për prodhuesit** e artikujve Nr. 1, 3,4,5,6,7,11,12 dhe Nr.19. Certifikatat të jenë të leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, brenda afatit të vlefshmerisë, në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara.

Nga verifikimi i dokumentacionit te ngarkuar ne Spe rezulton se Certifikatat e larte permendura, nuk jane te vlefshme per arsye se nuk jane te njesuara me origjinalin, por jane vertetuara me vertetim nenshkrimi perkthyesi zyrtar, ne kundërshtim me kërkesat e DST ku parashikohet se ***“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”***

Për sa më sipër, KVO në unanimitet vendosi për skualifikimin e ofertës së OE BOLT shpk.

- **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE RO-AL - me NIPT J61811001M, Adresa: Tiranë, Kashar, Km 8, Autosdrada Tiranë-Durrës, KVO vlerëson dhe vendos si më poshtë:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kësaj shoqërive rezultoi se ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në Kriteret e Përgjithshme për Kualifikim (KPK).

Nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga ana e KVO-së rezultoi se nga përllogaritjet e kryera, rezulton se, oferta e paraqitur, pas korrigjimit të veprimeve duhet të jetë në vlerën totale pa tvsh **6,129,965.00** lekë pa TVSH, ndërsa në formularin e ofertës ky OE ka deklaruar ofertën **6,269,965.00** lekë pa TVSH. Referuar nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilin përcaktohet shprehimisht: *“Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme: Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar[...]”*, nga veprimet aritmetike të kryera të të gjithë formularit te ofertes të paraqitur, rezulton se oferta e operatorit ekonomik RO-AL ka gabime

aritmetike, gabime këto që tejkalojnë vlerën 2% të vlerës së ofertës ekonomike të ofruar nga ky i fundit. Diferenca e ofertës së deklaruar në formular ofertë, me atë të llogaritur nga çmimet e deklaruar në ofertë rezulton **(D1): 6,269,965.00 - 6,129,965.00 = 140,000.00**.

2% i vlerës së ofertës ekonomike (D2) : 2% e 6,269,965.00 = 125,399.30.

Pra gabimi aritmetik i llogaritur e tejkalon vlerën 2% të vlerës së ofertës ekonomike (D1 >D2).

Për sa më sipër, KVO në unanimitet vendosi për skualifikimin e ofertës së OE RO-AL shpk.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [**“Erzeni/SH Sh.p.k, me NIPT J66902027T”**, Adresë: Lagjja “Bahçallek, Rruga Nacionale Shkodër,] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [5,791,955 (pesë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë)/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [autoritetit kontraktor përfitues/MSHMS /Drejtoria e Prokurimeve, Koncesioneve dhe PPP] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda ____5_____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 03.07.2020

Ankesa: Po

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë 15.07.2020.

* * *

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Gelardina Prodani